

Komisioni për Ankesa – shkalla e dytë, në përbërje prej Sitki Baftiu kryetar , Remzi Azemi dhe Bekim Behrami anëtarë, në mbledhjen e mbajtur me datë: 10.05.2022 shqyrtoi ankesën e Eroll Salihut me nr. Ref.1056/1 datë: 06.05.2022 lidhur me vendimin e komisionit diciplinor të shkallës së parë të datës: 28.04.2022 dhe për të njëjtin duke iu referuar fakteve dhe provave nga lënda në shqyrtim lidhur me rastin, bazuar në dispozitat e Rregullores disiplinore Neni 119 Pika: a, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Refuzohet si e pabazuar** ankesa e Eroll Salihut e datës: 05.05.2022 e parashtruar kundër Vendimit të Komisionit Disiplinor-shkallës së parë të datës 28.04.2022.
- II. **Vërtetohet** Vendimi i Komisionit disiplinor-shkallës së parë i datës 28.04.2022 me të cilin Eroll Salihut i janë shqiptuar masa disiplinore-dënimi në të holla në shumën prej 200.00 Euro të cilën shumë obligohet t'a paguaj në afat prej 8 ditësh pasi që vendimi të bëhet i formës së prerë, dhe masa disiplinore-dënimi me ndalim në kryerjen e funksioneve si Drejtor për çështje sportive dhe Këshilltar i lartë ligjor i FFK-së, në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili është i ekzekutueshëm nga momenti i shqiptimit.

A r s y e t i m

Komisioni për Ankesa – shkalla e dytë në mbledhjen e mbajtur më datë: 10.05.2022 pas shqyrtimit të të gjitha shkresave, argumenteve dhe provave shtesë të deponuara nga ana e palës së ankimuar respektivisht nga Eroll Salihu, komisioni konstaton se pala në procedurë në asnjë rrethanë nuk ka prezentuar fakte relevante që ky komision do t'i kishte ballafaqur në secilin pretendim të tij.

Komisioni për Ankesa gjatë shqyrtimit të ankesës së Eroll Salihut gjeti se i njëjti nuk ka prezantuar asnjë fakt, dëshmi apo provë në realizimin e pretendimeve të tij të dhëna në emisionet televizive, pranë komisionit disiplinor dhe komisionit për ankesa.

Komisioni i Ankesave duke trajtuar ankesën në hollësi dhe Vendimin e Komisionit disiplinor të shkallës së parë, konstaton me të drejtë të plotë se në rastin konkret kryesi i kundërvajtjes ka shkelur nenin 61 paragrafi 1, pika b) të Rregullores Disiplinore ku parashihet se: *“Anëtari i organeve të FFK-së, apo zyrtari i klubit i cili fyen, shpife ose përhapë të paverteta për klubin tjetër, për lojtarin e vet apo kundërshtarët, për punëtorin e futbollit të cilitdo klub apo anëtarë të udhëheqesise se organizates se futbollit te te cilitdo organ, per gjyqtarin ose trajnerin, do te denohet funksionari, me ndalese te kryerjes se funksionit prej 6 (gjashtë) muaj deri ne 1 (një) vite dhe denim me te holla 200€ deri 2000*

€". Në nenin 63, paragrafi 1, pika d) të kësaj rregulloreje parashihet se: *"Të gjithë personat të cilët nuk e aplikojnë kodin e sjelljes (të cilët shkelin dispozitat e Kodit do të dënohen: Punetori futbollit prej 3 muajve deri ne 1 vite por ne raste edhe me te renda perjashtim nga organizata e futbollit", si dhe në nenin 8, të Kodeksit për mirësjelljen e anëtarëve të FFK-se parashihet se: "Anëtarët e organizatave të futbollit nuk guxojnë gjatë deklaratave për media, të ofendojnë apo të përuhin institucionet e organizatave të futbollit, të anëtarëve individual të tyre, nuk guxojnë të përhapin të pavërteta dhe të dhëna të rrejshme apo të gabuara lidhur me punën e institucioneve të futbollit dhe individëve, anëtarë të organizatave të futbollit."* Komisioni i Ankesave konstaton se komisioni i shkallës së parë me të drejtë ka zbatuar dispozitat e lartcituara, të cilat edhe janë shkelur në rastin konkret nga kryesi i kundërvajtjes.

Komisioni për Ankesa vjen në përfundim se kryesi i kundërvajtjes Eroll Salihu me veprimet e tij ka bërë shkeljen e dispozitave të lart cituara dhe masat që komisioni disiplinor-shkalla e parë i ka vendosur me vendimin e saj, janë konfrom në përputhje me shkeljet disiplinore të kryesit të kundërvajtjes. Gjithashtu komisioni i ankesave konsideron se veprimet e zyrtarit të FFK-së që shkelin statusin dhe normativën e saj me qëllim dhe për arsye të caktuar, lehtë mund ta dëmtojnë edhe imazhin e shtetësisë së Kosovës nëpërmes futbollit në arenën vendore dhe ndërkombëtare.

Andaj duke u bazuar në të cekurat si më lart, në përputhje me nenin 119, pika a) të Rregullorës Disiplinore, Komisioni i Ankesave e refuzoi ankesën e kryesit të kundërvajtjes, dhe e vërtetoi vendimin e shkallës së parë.

Prishtinë:

Datë 10.05.2022

Sitki Baftiu, kryetar i Komisionit të Ankesave

